



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 14.07.2015, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Anila Agalliu, Vexhi Muçmataj, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Tahir Muhedini, Nard Ndoka.

Mungojnë:

Dashamir Peza, Silva Caka, Fatmir Mediu, Mhill Fufi, Tom Doshi

Të ftuar:

Arbjan Mazniku - zëvendësminister

Plarent Ndreca - sekretar i Përgjithshëm i MAS-së

Alekasandër Xhuvani – anëtar i Komisionit të Arsimit të Lartë

Erzen Tola - drejtor i Drejtorisë Juridike

Erjon Muharremaj - këshilltar juridik i Komisionit të Arsimit të Lartë.

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj - Kreu XII.

“Institucioni publik i pavarur i arsimit të lartë”.

Para se të vazhdojmë shqyrtimin nën për nën, do t’iu lutesha përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit, sepse kemi rënë dakord për disa formulime që do të sillen prej tyre, në mënyrë që të bëjmë raportin e komisionit. Nuk do të dëshiroja që ky shkak të jetë pengesë për të vonuar raportin, për të penguar komisionin tjetër, për rrjedhojë shqyrtimin në seancë plenare. Deri tani kjo marrëdhënie ndërmjet ekipit të caktuar nga ky komision dhe ministrisë ka qenë shumë e mirë. Unë dëshiroj t’ju falënderoj, por besoj se edhe këto dy ditë do të punojmë me të njëjtin ritëm dhe frymë bashkëpunimi që të mund ta përmbyllim me sukses këtë proces.

Neni 116. “Institucionet publike të pavarura të arsimit të lartë”.

Po, zonja Hysi në cilësinë e relatores.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Kemi pasur një diskutim shumë të gjatë kur kemi bërë diskutimin në parim dhe kemi kërkuar informacion për një sërë pyetjesh. Ministria e Arsimit ka sjellë përgjigjet me shkrim. Nga relacioni rezulton se jepen sqarime se pse krijohet ky lloj institucioni që është institucion i së ardhmes, por jo detyrimisht menjëherë me hyrjen në fuqi të ligjit, pasi në dispozitën kalimtare i është lënë një periudhë e caktuar kohe.

Dy pyetjet që kemi shtruar, por nuk kanë marrë përgjigje janë: a mund të krijojë një OJF në formën e një fondacioni një ent publik? Nëse themi “institucion publik i pavarur”, i pavarur nga cili? Entet publike kanë varësi dhe kontrollohen nga shteti duke ruajtur pavarësinë e tyre, por në format që përcaktohen në ligjin që rregullon entet publike. Në diskutimin e këtij neni ne kemi mbajtur parasysh edhe atë që thuhet në Kodin Civil, se çfarë janë fondacionet, si krijohen dhe si shpërndahen ato. Ka një mospërputhje të këtij kreu dhe nenit 16, pika 4, sepse në përkufizimin që u është dhënë institucioneve publike është pranuar vetëm forma e krijimit të tyre nga shteti, ndërkohë këtu ka dy forma: një transferim dhe një krijim nga OJF-të. Duhet të biem dakord se cila do të jetë forma përfundimtare. Nëse do ta lëmë që këto institucione, të cilat krijohen do të jenë publike të pavarura, atëherë ato nuk mund të krijohen me kërkesën e një organizate jofitimprurëse. Paratë mund të lihen me testament, mund të jenë me dhurim, mund të jenë nga fondacionet, por krijimi i tyre duhet të bëhet vetëm me ligj ose me vendim të

Këshillit të Ministrave. Ky i fundit merr vendimin e themelimit, por kurrësi nuk bën atë që thuhet, pra miratimin e një kërkesë që vjen nga një OJF. Kjo është për sa i përket nenit 116.

Në varësi të këtij formulimi “person juridik publik” rrjedhin dhe një sërë nenesh të tjera. Nëse do të pranojmë se këto institucione do të jenë persona juridikë publikë, pra do të jenë universitete publike, por me një pavarësi, unë do të thosha më tepër autonomi, sepse fjala pavarësi nuk ekziston as në Kushtetutë, në nenet 116, 117, 118 dhe 119 duhet të hiqet koncepti “themeluesi”, pasi themelues në këtë rast nuk mund të jetë OJF-ja, por Këshilli i Ministrave. Është ky i fundit ai që themelon një institucion të tillë publik të pavarur, gjë që kërkon që edhe në nenin 120 duhet të përcaktohen më qartë rregullat, të cilave u nënshtrohet një ent publik. Një ent publik u nënshtrohet rregullave të financimit si çdo institucion tjetër publik. Në praktikën tonë kemi shumë ente publike, kemi Entin Kombëtar të Banesave, Entin e Energjisë. Këto janë institucione publike të pavarura, por kanë rregulla specifike dhe nuk janë të pavarura nga shteti, nga kontrollet. Ato kanë bordet e tyre që menaxhojnë situatën, por në bordet e tyre nuk mund të jenë përfaqësues të OJF-ve që kanë fondacione të krijuara nga një OJF, por janë krijuar gjithmonë ose me ligj, ose i ka krijuar Këshilli i Ministrave.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Hysi!

Ka komente të tjera?

Të dëgjojmë përfaqësuesit e ministrisë.

Arbjan Mazniku – Institucionet publike të pavarura të arsimit të lartë vijnë në këtë ligj si një nevojë dhe si pjesë e një diskutimi të gjatë për të krijuar një institucion publik, që të gëzojë një nivel më të lartë autonomie, afruar me pavarësinë, e cila ishte e pamundur të krijohej në suazën e institucioneve publike ekzistuese, si një institucion alternativ i ndryshëm nga ai publik, i cili ka një nivel më të lartë kontrolli dhe mbikëqyrjeje nga institucionet publike, si dhe incentivë nga ana tjetër për institucionet publike që të kenë mundësi të lëvizin në këtë drejtim, që në këtë hapësirë të re të krijuar të gëzojnë një nivel më të lartë lirie funksionale, administrative dhe financiare.

Nëse do ta shikojmë çështjen përtej definicioneve të emrave, por nga këndvështrimi i organizimit institucional, institucionet publike ekzistuese, pavarësisht se jemi mësuar prej shumë vitesh t’i quajmë të tilla, ato *de facto* janë institucione shtetërore. Për sa i përket Ministrisë së Financave dhe një seti të tërë rregullash, ato funksionojnë si institucione varësie. Rregullat financiare të tyre, ato administrative, të punësimit dhe e gjithë struktura e rregullave, të burokracisë së brendshme funksionojnë si një institucion shtetëror. Nëse do të shikojmë

definicionet klasike, universitetet tona publike janë më shumë universitete shtetërore, sesa publike. Eksperienca botërore na ka treguar se kur institucionet akademike universitare marrin një nivel më të madh lirie, jo vetëm nga ana akademike, të cilin mund të themi se institucionet deri diku e gëzojnë, por nga ana organizative, institucionale, ato kanë mundësi të zgjerohen dhe të përmirësojnë në mënyrë të ndjeshme mënyrën e tyre funksionale. Synimi i komisionit ishte të gjenim një mekanizëm sesi t'u krijojmë këtyre institucioneve këtë frymë dhe këtë liri.

Së dyti, edhe në programin qeverisës, por edhe në atë që ka qenë fryma e përgjithshme e qeverisë, ka qenë logjika që arsimi i lartë është një shërbim publik në tërësinë e tij, pavarësisht se cili është aktori që e ofron, si dhe është një e mirë publike. Fryma që ka drejtuar komisionin, ka synimin për të krijuar një institucion, që pavarësisht se cili është aktori themelues, funksiononte si një institucion publik. Ka shumë shembuj të tillë në Europë ku kemi institucione, të cilat shërbejnë në dobi të publikut dhe jo detyrimisht janë krijuar thjesht dhe vetëm nga shteti.

Për t'iu përgjigjur në mënyrë të drejtpërdrejtë shqetësimit të zonjës Hysi, në këndvështrimin tonë nuk është fondacioni krijuesi i këtyre institucioneve, por është personi që bën kërkesën për krijimin e institucionit. Siç thotë pika 1 e nenit 116, ato krijohen nga vendimi i Këshillit të Ministrave. Më pas, po ky ligj i njeh fondacionit kërkesën të drejtat e themeluesit, pra nuk është themeluesi në kuptimin e mirëfilltë të ligjit. Themeluesi në kuptimin e mirëfilltë të ligjit mbetet Këshilli i Ministrave me vendimin e tij, ashtu siç ndodh edhe sot me institucionet publike. Pra, nga këndvështrimi teknik, ne mbetemi të mendimit, ose të paktën në mënyrën sesi është shkruar ky nen, që personi, enti që e krijon është Këshilli i Ministrave, duke i dhënë në këtë mënyrë autoritetin që të krijojë një person juridik publik me kërkesën e një fondacioni dhe duke i ruajtur këtij të fundit të drejtat e themeluesit. Në këtë mënyrë ne arrijmë të krijojmë një institucion publik me kërkesën e një fondacioni, duke ia ruajtur këtij të drejtat e themeluesit. Në këtë mënyrë, arrijmë të krijojmë një institucion publik me bashkëfinancimin e një financimi jopublik. Besojmë se kjo na krijon mundësinë që të krijojmë atë që ka qenë në mënyrë të vijueshme angazhimi ynë: angazhimi i më shumë i burimeve financiare dhe institucionale publike, por me burim nga privati.

Kjo ka qenë fryma mbi të cilin është ndërtuar ky koncept.

Dua të shpjegoj edhe diçka tjetër, që nuk lidhet ngushtësisht me këtë nen, por me gjithë frymën e këtij kreu. Meqë një shqetësim i vijueshëm për këtë koncept ka qenë tentativa që një person privat të ketë ndikim mbi entin që krijohet, ne kemi ngritur dy mure mbrojtëse. Muri i parë është që personi, i cili do të marrë këtë sipërmarrje, së pari duhet të krijojë një

fondacion, që sipas Kodit Civil e bën kalimin e aseteve, emrit dhe të financave të pakthyeshme mbrapsht. Më pas, fondacioni bëhet kërkues për institucionin të arsimit lartë publik të pavarur. Pasi ka plotësuar 20 kushte, Këshilli i Ministrave mund t’ia japë këtë status të posaçëm, duke krijuar murin e dytë.

Gjithashtu kemi parashikuar IAL-ja të jetë një person juridik më vete, i ndryshëm nga fondacioni. Përgjegjësitë e brendshme institucionale mbyllen te bordi i universitetit, nuk kalojnë te bordi i fondacionit, duke i dhënë në këtë mënyrë IALPP-së të gjitha elementet e plota të një personi juridik dhe pavarësinë mirëfilltë nga aktori që ruan thjesht pozicionin e themeluesit, çka përkthehet teknikisht në ligj vetëm në mundësinë që në proporcion me financimin që jep, të jetë i përfaqësuar në bordin e institucionit, i cili në vetvete është i vetëmjaftueshëm si bord.

Për shpjegime të mëtejshme teknike, mund t’i kaloj fjalën zotit Ndreca.

Plarent Ndreca – Është e rëndësishme të kuptohet një moment nga ana juridike. E preku pak Mazniku. Fondacioni nuk është thjesht OJF, por me qëllim të përcaktuar është përcjellë një nga llojet e OJF-ve, që është fondacioni.

Përveç faktit që ky institucion ka si element të tij parevokueshmërinë e të gjitha të mirave materiale që i vihen në dispozicion, ka edhe një element tjetër: ai që vë në dispozicion këto asete, nuk ka asnjë lloj akses në ekzekutimin e qëllimit të këtij fondacioni. Fondacioni krijohet për të realizuar një të mirë publike. Vetë themeluesi nuk ka akses në ekzekutimin e aktit të themelimit. Do të thotë, i besohet një bordi administratorësh, i cili ka vetëm një qëllim: të realizojë qëllimin e krijimit të fondacionit.

Përveç këtij momenti, kemi krijuar edhe një filtër, siç e parashikon vetë Kodi Civil: marrjen e vendimit nga Këshilli i Ministrave. Që ta marrësh këtë vendim, duhet të konsumosh disa kritere të përcaktuara.

Kur themi pavarësi, duhet të kemi parasysh distancën që krijon një entitet nga ekzekutivi, sepse ky është ai që ka interesa politike afatshkurtra. Kemi krijuar dy distanca nga ekzekutivi: kur një IALPP krijohet nga shteti, shteti duhet të krijojë një fondacion, një bord drejtorësh të tij, pastaj krijohet IALPP-ja.

Fatmir Xhafaj – Kush e do fjalën?

Po.

Mimoza Hafizi – Zoti Mazniku tha se po krijojnë një institucion mësimor që të ketë autonominë e mjaftueshme, meqë aktualet nuk e kanë. Lind pyetja: pse mos të jepet kjo autonomi e mjaftueshme, por detyrohem të krijojmë një institucion tjetër?

E dyta. IALPP-të, përveç autonomisë maksimale që kanë në krahasim me universitetet publike, kanë edhe një favor, që jep neni 120: për këto fonde të përfituara nga IALPP-ja, nuk zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë rregullat e shpërndarjes së të ardhurave, sipas standardeve të programimit buxhetor dhe as rregullat e prokurimit publik. Sigurisht, kjo krijon një lehtësi dhe një fleksibilitet të jashtëzakonshëm, të cilin në fakt universitetet tona publike ka kohë që e kërkojnë, por shteti nuk ua ka dhënë. A do të ishte më e thjeshtë që t'ua jepnim institucioneve këtë fasilitet, sesa të krijojmë të krijojmë institucione të reja?

E treta. Kam një pyetje për fondacionin krijues të IALPP-ve që do të krijohen nga transformimi i universiteteve aktuale publike. Në një debat, te një seancë të kaluar, keni thënë se këtë fondacion e krijon shteti. Është Komisioni i Ligjeve që e vlerëson këtë. Por për mua këtu nuk është e qartë nëse këtë fondacion e krijon shteti. Cili do të jetë institucioni shtetëror që do të kontrollojë marrëdhënien midis fondacionit, bordit dhe universitetit?

Faleminderit!

Plarent Ndreca – Po filloj me pyetjen e parë.

Të dytës do t'i përgjigjet zoti Mazniku.

Kur themi se një IALPP krijohet nga shteti, sigurisht krijohet nga Këshilli i Ministrave, i cili do të krijojë një fondacion, do të ketë një bord ekzekutiv të fondacionit dhe është ky bord që do të përcaktojë përfaqësuesit, me cilësinë e themeluesit, në bordin e IALPP-së.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ajo është pyetja që do t'i përgjigjet Mazniku.

Fola për pjesën e bordit. Anëtarët e bordit në rolin e themeluesit, sigurisht që do të jenë të qeverisë. Kjo është e qartë.

Fatmir Xhafaj – Zoti Mazniku.

Arbjan Mazniku – Për sa i përket pyetjes së buxhetit, logjika me të cilën është krijuar buxheti është të krijojmë një balancë të re midis lirisë dhe përgjegjësisë, që do të thotë: institucionet publike jo të pavarura kanë një nivel të caktuar lirie, nëpërmjet këtij ligji, më të madhe se ekzistuesja, por kanë gjithashtu edhe një nivel kontrolli që e balancon këtë gjë. Në këtë proces, ato duhet të marrin një nivel të caktuar rreziqesh. Nëse niveli i pagave të IAL është më i kontrolluar, IALPP-të funksionojnë në mënyrë të mirëfilltë të pavarura. Në këmbim të lirisë, marrin edhe përgjegjësinë, nëse duhet të zmadhohen apo zvogëlohen, në varësi të mënyrës se si funksionojnë. Universiteti i Arteve apo ai i Sporteve mund të mos kthehen kurrë në IALPP, por do të jenë në një mbrojtje më të madhe nga ana e shtetit. Institucionet që mund ta

përballojnë këtë nivel lirie, me vullnetin e tyre, kur e ndjejnë që mund të kërkojnë këtë nivel lirie, hapin një rrugë se si mund të shkojnë në atë drejtim. Nëse institucionet e para mund ta fillojnë në vitin 2017, të tjerave mund t'u duhen 10-15 vjet, derisa të arrijnë maturinë institucionale. Ky kalim do të jetë një moment negocimi midis tyre dhe Këshillit të Ministrave.

Pse duhet që shteti të hapë një fondacion dhe të mos e bëjë drejtpërdrejt?

Nëse qeveria do ta akordonte automatikisht këtë stad, do të ishte shumë e vështirë të krijohej mundësia e shkëputjes së mirëfilltë nga rregullat e buxhetit, sepse nga ana institucionale, nga ana e menaxhimit financiar dhe të aseteve, do të mbeteshin shtetërore. Nëpërmjet këtij kalimi, ku asetet publike i kalojnë këtij fondacioni të themeluar nga Kryeministria, fondacioni bëhet një fond besimi, i cili krijon mundësinë më pas që të vetëfunksionojë. Përpëlitja që kemi pasur, ka qenë: si mund të gjejmë mekanizma që të bëjmë që institucioneve me maturinë institucionale t'u krijojmë lirinë më të madhe.

Kemi parë se si e kanë bërë edhe vendet e tjera. Para 12 vjetësh (1999-2001), Portugalia ka ndjekur një rrugë pothuajse identike. Ka krijuar ato që quhen fondacione, në një rrugë shumë të ngjashme me këtë. U krijua një fondacion nga shteti, i cili është mbajtësi i aseteve dhe i licencës së universitetit, dhe u dha këtyre universiteteve një liri shumë të madhe funksionale së brendshmi. Ato universitete sot janë në 10-15 më të mirat në Europë, duke ngritur 50-60% të të ardhurave të tyre nga projektet kërkimore-shkencore në hapësirën europiane apo partneritete shumë të forta që kanë krijuar me biznesin.

Sot institucionet tona janë në një mur institucional, por edhe mendor, për mënyrën se si funksionojnë: marrin para nga buxheti, japin mësim dhe kaq. Nuk e kanë mundësinë që të hyjnë në marrëdhënie me palë të treta me projekte të kërkimit shkencor apo bashkëpunimi me biznesin. Kur flasim për biznesin, një pjesë e madhe thonë se kjo nuk ka për të ndodhur në Shqipëri. Ne besojmë se kjo nuk ndodh, ngaqë nuk i kanë rrugët e duhura të komunikimit institucional.

Fatmir Xhafaj – Ju jeni të bindur se kjo nuk krijon kundërshtim me rregullimin që keni sot në Kodin Civil?

Plarent Ndreca – Në nenin 25 të Kodit Civil është përcaktuar shumë qartë se çfarë janë entet publike dhe nga duhet të financohen. Aty thuhet se janë ato që njihen me ligj si të tilla. Ne këtë kemi bërë: e kemi njohur me ligj si institucion. E kam fjalën për institucionet e arsimit të lartë. Kjo shkon në harmoni të plotë me Kodin Civil.

Fatmir Xhafaj – Kam dy gjëra me ju, zoti Mazniku.

Thatë: ruajtja e të drejtave të themeluesit. Ishte lapsus apo kishit parasysh diçka konkrete? Nga njëra anë flisni për shkëputje midis themeluesit dhe IAL-së, nga ana tjetër flisni për konceptin e ruajtjes së disa të drejtave ndikuese të themeluesit mbi institucionin.

E dyta. Si e keni parashikuar kontrollin e shtetit në vazhdim?

E treta. A ka një mënyrë tjetër përveç rastit të Portugalisë, që e merrni si model, që do të ndihmonte institucionet tona arsimore të fitojnë të njëjtat vlera, pa bërë gjithë këtë xhiro?

Nuk besoj se ndryshimi i statusit do të ndryshonte edhe mentalitetet.

Arbjan Mazniku – Po e nis nga kjo e fundit. Në Europën kontinentale pjesa më e madh e universiteteve janë krijuar nga shteti, në 100-150 vjetët e fundit, dhe funksionojnë ngushtësisht si universitete shtetërore. 10-15 vjetët e fundit ka një tendencë për t'u dhënë pavarësi më të madhe.

Fatmir Xhafaj – Më fal! Ju nuk mund të më thoni që universitetet gjermane, të cilat janë publike, janë më të dobëta se universitetet e Portugalisë.

Arbjan Mazniku – Nuk mund ta them këtë, por krahasuar me ekonominë gjermane, ato janë më të dobëta sesa universitetet angleze. Pothuajse nuk ka asnjë gjerman në 100 universitetet më të mira në botë. Edhe nga ana e nivelit të patentave, të kërkimit shkencor dhe të ndërkombëtarizimit universitetet angleze janë përpara. Universitetet gjermane, të cilat janë shtetërore, tani po e shikojnë këtë problem. Debati që po bëjmë ne, është edhe në Gjermani. Edhe raste të tjera ka. Rrugë të ngjashme ka ndjekur edhe Turqia para 10-12 vjetësh, me një nivel suksesi. Pjesa më e madhe e vendeve skandinave kanë një model të tillë, të cilin e kanë ndjekur para 20-25 vjetësh. Pra, trendi europian është në këtë rrugë. Në shumicën e rasteve, rruga e gjetur ka qenë rruga e të qenit institucione – fondacion, që jep mundësinë e vetëmjaftueshmërisë dhe të shkëputjes nga shteti, kur ato mund të shkojnë në këtë rrugë.

Në pikën 7, të nenit 116, themi: “Në kuptim të këtij ligji, fondacioni konsiderohet themelues i IALPP-së”. Pavarësisht se kemi thënë në pikën 1 të të njëjtit nen që krijohen nga Këshilli i Ministrave, për t'u dhënë statusin publik në përputhje me Kodin Civil, u ruajmë disa të drejta nëpërmjet pikës 7, të cilat ngushtohen te fakti që ai ka të drejtë të delegojë në bordin administrativ në momentin zero, në momentin e krijimit të institucionit, 6 nga 11 anëtarë të bordit. Gjithashtu, kemi që ky numër i njerëzve në bord ndërron në përputhje me financimin, që do të thotë: nëse një institucion krijohet nga një fondacion jo i krijuar nga shteti – rasti i dytë i institucioneve publike – në momentin që ai fondacion kërkon para publike, ai duhet të lëshojë njerëz nga kjo gjashtëshe, duke i zëvendësuar me njerëz nga financuesi alternativ, që është shteti.

Fatmir Xhafaj – Cili është risku i falimentimit?

Që ta bëj të qartë: e quaj hap pozitiv. Por ka disa pikëpyetje, të përthyer në realitetin shqiptar, përtej vullnetit të mirë të cilësdo qeveri apo cilitdo individ, që duhen marrë në konsideratë, që këto të mos kthehen në disa nisma ballkanike, me sfond ballkanik dhe me fat ballkanik.

Sapo ma orientuat se Gjermania është vend me ekonomi të fortë por universitetet i ka të dobëta. Ndërkohë, flisni për një realitet që e ka të pamundur për të ngritur nisma të tilla me kapitalet e veta. Ky biznes së pari kërkon të dijë se sa fiton dhe jo se sa do t'i japë shoqërisë. Mirë është ta kemi një minimum garancie, sesa të pretendojmë diçka që nuk e kapim dot.

Cili është risku dhe sa e keni llogaritur?

Arbjan Mazniku – Kemi bërë një debat të gjatë për këtë. Është një pyetje shumë e drejtë dhe unë ju falënderoj për këtë.

Kemi dy skenarë të mundshëm. Skenari i parë është kur një institucion i arsimit të lartë të pavarur, me një fondacion me origjinë privat, rrezikon që të falimentojë. Në atë moment, shteti është mes dy alternativave. Alternativa e parë, ligji ia krijon mekanizmat: ky nuk i shërben më interesit publik, ose kostoja për ta mbajtur është më e madhe sesa dobia publike. Në atë rast, e lë të falimentojë. Në rastin kur sheh se dobia publike nga institucioni është më e madhe, mekanizmat janë se nëpërmjet financimit dhe marrjes së kontrollit të bordit, ta shpëtojë si institucion dhe ta ruajë në dobi të interesit publik.

Fatmir Xhafaj – Sot e ke kontrollin 100%. Ju thoni: “Po bëj një xhiro dhe po vij prapë kur ta kem në pozicion falimentimi”.

Arbjan Mazniku – Në raste rreziku.

Gjykojmë se nëpërmjet këtij mekanizmi përfitojmë një të mirë publike nga këto institucione dhe na jepet zgjedhja që nëse shohim se është një e mirë publike, shteti e ka mundësinë ta ruajë, nëse nuk vlen, e lë që të humbasë.

Fatmir Xhafaj – Po, zonja Hafizi.

Mimoza Hafizi – Meqë ky debat po vazhdon, po shtoj ndonjë argument.

U përmend rankimi, që në fakt është kontestuar edhe nga shumë vende të zhvilluara. As unë nuk do t'i pranoja instrumentet e tij si argumente absolute.

E dyta. Edhe në përgjigje të vizionit që hapi kryetari Xhafaj, me sa shoh, po ju mund të ma kundërshtoni, shembulli i Portugalisë është ai që po kërkojmë në komision. Është krijuar një fondacion dhe të gjitha universitetet kanë kaluar në këtë status. Ndërkohë, te ne ndërtohet një institucion ndërmjetës, por për më tepër të drejtën për t'u kthyer në këto tipa institucionesh

e kanë edhe universitetet jopublike. Kjo krijon një situatë defavorizuese për universitetet publike, sepse universitetet jopublike futen në këtë sistem me tarifa shumë të larta, ndoshta dhjetë herë më të larta. Nëse këto marrin edhe favoret për të marrë edhe fonde publike, edhe favoret të kenë liri për të mos respektuar rregullat e financimit publik, atëherë krijohet një polarizim shumë i madh mundësish. Kjo është situata që shoh unë.

Fatmir Xhafaj – Për të parë efektshmërinë e këtij shndërrimi dhe suksesin e këtij procesi, a mund të shohim diçka që e gradualizon dhe e mbron këtë proces? Keni vënë një vit: 2018. Një ditë të bukur, të gjitha universitetet thonë...

Do të thoni ju se e ka qeveria, por kjo qeveri ka bërë edhe firmat piramidale. Qeveritë i kanë bërë, nuk i ka bërë populli. Askush nuk mund të thotë se jam unë garancia. Si mund ta mbrojmë edhe nga ky lloj voluntarizmi? Mund ta kem edhe gabim.

Në thelb, i mbështes. Kam një përvojë personale që universitete të tilla, sidomos ato që janë mbi bazë themeluesish, janë të suksesshme. Por garancitë duhet të jenë shumë të forta.

Plarent Ndreca – Në parim, nuk është se ndajmë një qëndrim të ndryshëm, sepse sa më shumë garanci, aq më mirë është. Në fakt, “falimentim” nuk është termi i saktë.

Fatmir Xhafaj – E përdora për ta bërë më të kapshme.

Plarent Ndreca – Në konceptin e fondacionit ka vetëm shpërndarje. Kur nuk arrihet qëllimi për të cilin është krijuar, shpërndahet dhe të gjitha të mirat e krijuara shkojnë prapë për të njëjtin qëllim. Shpërndahen nga gjykata shqiptare. vetëm prej saj.

Për t’u kthyer te argumenti, garancia kryesore është se ato subjekte që kanë për qëllim fitimin nuk kanë asnjë interes për të kaluar në IALPP. Do t’ia besojë pasurinë e tij disa personave që do ta ekzekutojnë aktin e themelimit të tij.

(Ndërhyrje pa mikrofoni.)

Unë nuk po flas në bazë të ngjashmërive, por në bazë të ligjit.

Ligji e parashikon kështu.

Kjo është një garanci për shqetësimin që ngritët, zoti kryetar.

Megjithatë, në ligj janë parashikuar dy momente të tjera: njëri është afati që përmendët, por edhe fakti që duhen ristrukturuar këto institucione sipas këtij ligji.

Nëse gjykohet se do të ketë ndonjë filtër tjetër të arsyeshëm...

Bashkim Fino – Të kërkoj ndjesë, sekretar i Përgjithshëm, por nuk u mbajta dot, sepse e ke thënë disa herë. Kam respekt për veten, më vjen keq kur e dëgjoj sikur po na bëni për budallenj. Gjithsesi, të kërkoj ndjesë që ndërhyra!

Kam një pyetje të thjeshtë, zoti kryetar. Ajo lidhet me nenin 120. Dua të di: ky është një vlerësim politik, që ka bërë qeveria, apo Ministria e Financave dhe APP e kanë lënë me dashje që kjo, e famshmja IALPP, mund të menaxhojë fondet jashtë çdo lloj kontrolli të buxhetit dhe jashtë prokurimit publik? Meqë është person juridik publik, nuk mund të bëjë financime publike jashtë prokurimit publik. Pika 7 e nenit 116, me nenin 120 më duken nonsens.

Fatmir Xhafaj – Zoti Mediu.

Fatmir Mediu – Ligji “Për prokurimin publik” i ka përcaktuar rastet përjashtimore. Nuk është as në autoritetin e qeverisë, as të ministrisë që fondet që vijnë si fonde buxhetore të prokurohen jashtë ligjit.

Arbjan Mazniku – Kjo është sfida që kemi pasur. Si të gjendet një mekanizëm për t’u lejuar institucioneve të arsimit të kenë fleksibilitet financiar, i cili është mjaft më i madh sesa institucionet tipike shtetërore. Logjika është: na intereson arsimi cilësor. Por duam që pajisjet t’i blesh në këtë mënyrë, pedagogët t’i çosh në këtë mënyrë në konferencat ndërkombëtare etj. Pra, i kërkojmë edhe produktin, edhe procesin. Kjo është parë në përvojat botërore.

Ato nuk ikin dot nga KLSH-ja. Neni 120 nuk i detyron që të ndjekin të njëjtat rregulla procedurale që ndjek Ministria e Arsimit. Synimi i konceptit të IALPP-së ka qenë krijimi i mekanizmit financiar ku vazhdojnë të kenë kontroll, por të mos kenë ngushtësinë që kanë institucionet shtetërore.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Ka ndonjë gjë që duhet ndryshuar te neni 116?

Po.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, unë e ndoqa me vëmendje diskutimin e zotit Mazniku, dhe nuk jam kundër që të kemi institucione publike të pavarura, por problemi qëndron se a mund të krijohet një institucion publik, kur pasuria vjen nga një institucion juridik privat dhe vullneti vjen nga një OJF, fondacion? Nuk mund të quhet publik, kur krijuesi është një person juridik privat, një OJF.

Fatmir Xhafaj – E sqaroi. Nëse është një individ, i kërkohet të bëjë një fondacion. Për krijimin e këtij fondacioni vendos Këshilli i Ministrave.

Cili është problemi?

Vasilika Hysi – Pasuria është private. Vdes personi dhe do të lërë një testament. Këtë ligji duhet ta thotë hapur.

Fatmir Xhafaj – Ia lë shtetit.

Vasilika Hysi – Nëse e ka shteti, nuk ka problem.

Fatmir Xhafaj – Ai thotë: “Kam lënë kaq euro për universitet në Shqipëri”.

Vasilika Hysi – Kjo është normale.

Fatmir Xhafaj – Shteti do ta krijojë fondacionin. Ku qëndron problemi?

Vasilika Hysi – Kjo tregon se sa i paqartë është kreu.

Fatmir Xhafaj – Pse?

Vasilika Hysi – Sepse po bëjmë kaq shumë diskutime. Pra, që institucionet publike të kthehen në të pavarura, është më se normale. Nëse do që të kenë të drejtë të administrojnë pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, këtë ia jep me ligj dhe nuk ke nevojë të krijosh një fondacion. Nga 11 anëtarë që ka bordi, 6 janë nga themeluesi. Pra, nuk e di se sa i pavarur është fondacioni nga themeluesi.

E dyta. Nuk kam shqetësim që institucionet publike të kthehen në të pavarura.

Fatmir Xhafaj – Më falni, nëse Bill Gejts vendos të japë 10 miliardë euro... Nuk do të ketë as 6 me 5.

Vasilika Hysi – Ai nuk është publik, por privat.

Fatmir Xhafaj – Vetëm të drejtën e krijimit do të ruajë. Emrin dhe pllakën. Nuk do të merret Bill Gejtsi të bëjë universitetin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem! Ka ndonjëri ndonjë gjë për pikat nga 1 deri në 7?

Vasilika Hysi – Unë nuk kam, por pika e fundit, në kuptim të këtij ligji “fondacion konsiderohet themeluesi” nuk qëndron, sepse kuptimin e fondacionit e jep neni 54 i Kodit Civil.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni!

Mimoza Hafizi – Në lidhje me nenin 116, por edhe me pyetjen tuaj, a ka ndonjë mënyrë më graduale dhe më të përshtatshme për ta pranuar këtë, dhe me argumentin që na dha zoti Mazniku për Portugalinë, ne mund të bënim shumë mirë që këto institucione të kishin të drejtën ose të krijoheshin në fondacione të themeluara, ose nga transformimi i universiteteve publike, pra, të mos ia lëmë të drejtën institucioneve jopublike aktuale që të transformohen në IAL. E kisha fjalën për nenin 116/3. Në këtë rast, mund të shkruhej: “IAL publike ekzistuese mund të transformohen në IALPP”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Si e mendoj unë? Nuk mund t’ua heqim këtë të drejtë, por mund të shikojmë te Dispozitat Transitore, që të ndryshojmë kohën e afatit, për të hequr çdo lloj

mjegulle për këtë proces, për të bërë një ndryshim midis kalimit të institucioneve publike dhe kalimit të institucioneve private. Pra, për ta ndarë në kohë: për t'u dhënë më shumë kohë dhe për të pasur shteti më shumë garanci.

Arbjan Mazniku – Sot gjendemi para një situatë ku institucionet e arsimit të lartë publik janë në një gjendje stanjacioni...

Fatmir Xhafaj – E dëgjova nga Kryeministri këtë ligjëratë. Nuk do t'i shtosh gjë të re.

Arbjan Mazniku – Jo.

Thelbi është ky: ne duam që, duke i lejuar institucionet e arsimit të lartë të shkojnë në këtë drejtim, qëllimi është që t'u japim një nxitje për t'u transformuar dhe ecur përpara.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Por privatëve jepuni kohë: të mbikëqyrësh, ta rankosh, ta vlerësosh etj. Akoma nuk i keni mbaruar vlerësimet. Le të konsolidohen privatët.

Arbjan Mazniku – Te universitet publike ia kemi lënë Senatit që të vendosë. Gjasat janë që me këtë skemë...

Fatmir Xhafaj – Ndërkohë privatët kanë vrapuar.

Pse të mos prevalojë interesi i publikut, sepse nuk kemi interes, siç thoni, institucionet publike?

Arbjan Mazniku – *De facto*, institucionet e arsimit të lartë publik janë monopole.

Fatmir Xhafaj – Jo aq...

Arbjan Mazniku – Janë monopol i plotë. Nëse dua të studioj për ekonomi në Tiranë, më duhet të shkoj te Fakulteti Ekonomik. Nuk kam ku shkoj tjetër.

Fatmir Xhafaj – Po privatet?

Arbjan Mazniku – Ato janë me shumë para.

Fatmir Xhafaj – Këto do të jenë me më pak?

Arbjan Mazniku – Shumë më pak.

Fatmir Xhafaj – Ju po vini edhe kredi...

Arbjan Mazniku – Do të kenë tavane financiare njësoj si publiket.

Fatmir Xhafaj – Do ta shikojmë këtë, kur të vijë koha. Po paralajmëroj që do të bëjmë një ndryshim.

Vasilika, a ke ndonjë kuptim tjetër për “fondacioni konsiderohet themeluesi i IALPP-së”?

Vasilika Hysi – Nuk kam. Atë e ka dhënë Kodi Civil.

Fatmir Xhafaj – A mund të themi: “Fondacionit i njihet e drejta e themeluesit të IALPP-së”? Ta zbusim pak.

Dakord.

Plarent Ndreca – Ndryshimi është te fakti që këtu njihet si themelues i IALPP-së dhe Kodi Civil nuk e rregullon këtë. Kodi Civil rregullon se kush është themeluesi i fondacionit.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

A mund ta bëjmë “Fondacionit i njihet e drejta e themeluesit të IALPP-së”?

Dakord.

Faleminderit!

E mbyllëm këtu nenin 116. Me sa shoh, e mbyllëm pak a shumë kreun.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sapo të mbarojmë seancën, do të vijmë këtu.

I lini materialet mbi tavolinë, ashtu siç janë.

(Pas pushimit)

Vazhdojmë atje ku e kemi lënë diskutimin.

Neni 117. “Kriteret e krijimit të ALPP-së”. Kemi ndonjë gjë për të thënë?

Vasilika Hysi - Kam një pyetje. Te germa “c”, kur thoni: “Themeluesi i kalon të drejtën e përdorimit”, pra pasuria e një fondacioni do të kalojë vetëm në përdorim. Ka raste, për shembull që një person lë një testament dhe do të krijojë një universitet. Në këtë rast universiteti ka vetëm të drejtën e përdorimit? Cili është pronari i kësaj pasurie?

Plarent Ndreca - Për këtë arsye pronari është fondacioni, pra ai që vendos të lërë një pasuri, sigurisht do t’ia lërë fondacionit, ai themelon një fondacion, nëse destinon një pasuri drejtpërdrejt te IALPP-ja, ajo është pasuri e IALPP-së, e cila administrohet me të gjitha tagrat e pronarit nga IALPP-ja. Kur themeluesi themelon fondacionin, pasuria i shkon pastaj fondacionit.

Fatmir Xhafaj - Dakord me nenin 117.

Neni 118. “Mënyra e krijimit të IALPP”-së.

Keni vënë një shënim që kërkohet vullnet shtetëror. Kam përshtypjen se është e qartë çështja e vullnetit. Për krijimin është vullneti i qeverisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vasilika Hysi - Pika 3 mund të jetë objekt diskutimi. Nëse e kam kuptuar Arbrin saktë, ju thatë se fondacionin e themelon shteti apo jo? Nëse shteti themelon fondacionin, kërkesa për themelim i dërgohet përsëri Këshillit të Ministrave. Shteti e krijon dhe fondacioni i krijuar nga shteti i drejtohet Këshillit të Ministrave.

Fatmir Xhafaj - Ideja e auditimit është shumë e saktë.

Vasilika Hysi - Pika 2.

Fatmir Xhafaj - Kërkesa për themelimin i paraqitet për miratim Këshillit të Ministrave. Nga pikëpamja ligjore nuk mund të thuhet për shqyrtim, pasi nuk njihet procesi i shqyrtimit si akt veprimi.

Plarent Ndreca - A mund të sqaroj një moment? Po bëj një paralelizëm, themelimi është një veprim që shpreh vullnetin e disa personave për të krijuar një organizatë, por personalitetin juridik apo aftësinë për të hyrë në marrëdhënie me të tretët ia jep një institucion. Në këtë rast është Këshilli i Ministrave, pra krijuesi në pikëpamjen...

Fatmir Xhafaj – Askush tjetër përveç Këshillit të Ministrave?

Plarent Ndreca - Po, saktë në këtë kuptim, kurse themeluesi është personi që ka shprehur vullnetin për të krijuar një organizatë, por për të marrë fuqi juridike, Këshilli i Ministrave është filtri fundor.

Vasilika Hysi – Te pika 2, neni 118 thuhet: “Kërkesa për themelimin ose transferimin së bashku i paraqiten për miratim Këshillit të Ministrave”. Ndërkohë them se kërkesa për themelimin ose transferimin së bashku i paraqiten për të marrë vendim për krijimin e IALPP-së. E krijon Këshilli i Ministrave, apo jo? A jam e qartë?

Plarent Ndreca - Dakord. “I paraqiten për miratimin e krijimit Këshillit të Ministrave”.

Ne e kemi bërë “miratim”, sepse Këshilli i Ministrave del me një vendim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do të miratojë kërkesën e dikujt, prandaj e kemi bërë kështu, por si ta gjykoni ju.

Bashkim Fino - Kam një pyetje, te neni 118, pika 1: “Bordi Administrativ i IALPP-së vendos për transformimin e institucionit të arsimit të lartë me tre të katërtat e votave të anëtarëve të tij. Për këtë kërkohet paraprakisht mendimi i senatit akademik”. Po sikur të mos ketë mendim të tij, nuk do të kalojnë ata? Pse e vendosni me tre të katërtat dhe jo me gjysmën e bordit?

Plarent Ndreca - Është bërë me qëllim që të ketë një shumicë të cilësuar, në mënyrë që të mos bëhet më shumë i thjeshtë kalimi i një IALPP-je, sepse shumicën mund ta ketë

qeveria dhe për këtë arsye është lënë që të shkojë institucioni në atë pikëpjekje me shumicë të cilësuar.

Mimoza Hafizi - Kam një pyetje, te neni 118, pika 5 lidhet me transformimin e IAL-së publike, a ka dalë e qartë juridikisht që fondacionin për themelimin e IAL-së publike e krijon Këshilli i Ministrave? Mund të dalë një fondacion dhe mund të thotë..

Fatmir Xhafaj – Është thënë pak më lart, në një nen më parë.

Mimoza Hafizi - Pika 2 është për çdo IAL.

Fatmir Xhafaj - Këtu bën një përjashtim. Ky është rregulli i përgjithshëm. Në këtë rast do të veprohet kështu, pra e përcakton, sepse është çështja e kalimit të pronësisë. Aty është pronë private, ndërsa këtu është pronë publike.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Neni 119. “Bordi i administrimit”.

Vasilika Hysi - Këtu janë disa mendime të mbledhura edhe nga grupet e ekspertëve të së drejtës civile, por po të shikoni edhe Kodin Civil, thuhet se themeluesi nuk është pjesë e strukturave vendimmarrëse, sepse ai i jep paratë për të marrë një shërbim publik dhe IAL-ja ka personalitet juridik më vete. Duke i dhënë themeluesit shumicën e bordit, kjo tregon se nuk ka aq pavarësi, siç tha Arbri në fillim, që ne i krijojmë institucionet publike për të qenë të pavarura nga ekzekutivi. Në rastin konkret, kur fondacionin e krijon shteti, atëherë çfarë pavarësia ka nga ky i fundit?

Fatmir Xhafaj – Dakord, por logjika e të gjithë ligjit është që shumicën në bord e ka mbajtur gjithmonë ai që ka pjesën më të madhe të financimit, apo e kam gabim? Kush ka kontributin më të madh? Shteti e ka kontributin dhe e mban 100% dhe 90% kur do ta bëjë të përbashkët. I takon atij që ka shumicën, atij që është themeluesi dhe në atë rast mund ta ketë 100% vlerën e aksioneve. Te Bordi i Administrimit t’i ke marrë pakicën. Ai mund të thotë, unë e kam 100% bordin e administrimit, e krijoj unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Plarent Ndreca – Nëse ke shqetësimin për financimin publik, është një gjë, nëse financohet nga privati, atëherë është privat dhe vijon historia.

Po sqaroj edhe një moment në lidhje me mendimin që kanë dhënë civilistët, ata kanë të drejtë për pjesën që lidhet me krijimin e fondacionit, por ne kemi thënë jo pa qëllim, në kuptim të këtij ligji se themelues konsiderohet fondacioni, jo themeluesi i fondacionit. Pra, është Bordi i Administrimit të fondacionit që cakton anëtarë në Bordin e Administrimit të IAL-së dhe nuk është themeluesi ai që ka dhënë paratë në fillim. Në momentin kur krijohet

fondacioni, ai nuk ka më akses në ekzekutimin e aktit të themelimit të tij. Është Bordi i Administrimit të fondacionit që cakton anëtarët të Bordi i IAL-së. Kjo ishte arsyeja pse te neni 116, pika 7 kemi thënë: “Në kuptim të këtij ligji fondacioni konsiderohet themelues i IALPP-së”.

Fatmir Xhafaj - Dakord, të mos zgjatemi.

Ka ndonjë shpjegim tjetër?

Arbjan Mazniku - Pika 3, logjika që kemi ngritur është se katër vendet e senatit akademik dhe vendi që merr ministria në rolin e rregullatorit janë të palëvizshme. Lëviz gjashtëshja e themeluesit në varësi me financimin. Nëse themeluesi në rastin e një fondacioni të themeluar jo nga shteti, por nga një aktor privat, ai vazhdon të financojë në mënyrë të vazhdueshme fondin, është rasti që u përmend, kur ka një donator të madh, ka dhënë një sasi të caktuar lekësh për këtë punë, ai ruaj gjashtëshen në bord. Në momentin që ai vjen dhe kërkon para publike, duhet të lëshojë nga gjashtëshja. Kërkon gjysmën e parave, atëherë do të lëshojë tre nga gjashtë. Kërkon një të tretën e parave do të lëshojë dy nga gjashtë. Sa më shumë para publike kërkon, aq më shumë vende do të lëshojë nga gjashtëshja. Kjo krijon një sistem vetërregullues.

Fatmir Xhafaj - Bordi i aksioneve dikton vetëm maxhorancën, pra gjashtëshen dhe sipas këtij ligji nuk dikton pesëshen. Pesëshja mbetet e pandryshuar. Pesëshja mund të bëhet gjashtë, mund të bëhet shtatë, por gjashta nuk bëhet dot shtatë, tetë në këtë rast.

Po, zonja Hafizi.

Mimoza Hafizi - Dua të bëj një krahasim me nenin 47/2, ku keni përcaktuar në mënyrë shumë të detajuar sesi llogaritet pjesëmarrja në bord, pra si ndahet katërshja në rastin e universiteteve publike. Raporti i financimi nga tarifat e studentëve me financimin nga shteti. Pra, është një nen shumë i detajuar, ndërsa këtu nuk shikoj asnjë nen të detajuar sesi do të bëhet ndarja e këtyre gjashtë vendeve.

Fatmir Xhafaj - Gjashtë vendet i ka themeluesi. Ai do t'i caktojë të gjashtë.

Mimoza Hafizi - Gjashtë vendet i ka themeluesi kur financimi nga shteti është zero.

Fatmir Xhafaj - Po.

Mimoza Hafizi – Si në universitetin publik, ku katër vende i ka shteti dhe tre i ka universiteti, nëse financimi është zero. Aty është dhënë në mënyrë shumë të detajuar sesi ndodh progresivisht kur ndryshon financimi.

Fatmir Xhafaj - Në këtë rast, nëse shteti, ju, mendoni se do t'i bëjë të gjashta këto, nga do të vijjnë?

Mimoza Hafizi - A mund ta vazhdoj, që të mos ndërhyj disa herë? Pse nuk është dhënë në mënyrë të detajuar, ashtu siç është edhe në atë rast? Pra, se si do të ndodhë ky raport, si do të ndahen këto gjashtë vende. Ju thoni se do të ndahen sipas të ardhurave, pjesës së buxhetit që sjell shteti me pjesën tjetër. A do të llogariten në pjesën tjetër të ardhurat nga tarifat e studentëve? Në universitetet publike këtë raport e përcaktojmë mbi bazën e të ardhurave, të tarifave të studentëve, apo tarifat e studentëve kanë përcaktuar katërshen që ka senati akademik dhe pjesa tjetër është vetëm raporti i financimeve nga xhepi i fondacionit me financimin nga xhepi i shtetit.

Fatmir Xhafaj - Po, zoti zëvendësministër.

Plarent Ndreca – Institucionet e arsimit të lartë publik në vend kanë shumë qejf t'i quajnë të ardhurat nga tarifat si të ardhurat e veta. Në fakt në mënyrë strikte nuk janë të ardhurat e veta, por janë një e ardhur e deleguar nga qeveria për t'u mbledhur dhe për t'u administruar nga universiteti. Nuk është e vetja, sepse numri i studentëve i është dhënë nga vendimi i Këshillit të Ministrave, ndërsa tarifa i është dhënë nga Këshilli i Ministrave. Pavarësisht se ata kanë dëshirë t'i quajnë të vetat, por *de facto* është e ardhur e qeverisë shqiptare e përcaktuar dhe e deleguar për t'u mbledhur nga universiteti.

Në rastin konkret, për universitetet publike ne i kemi dhënë universitetit një mundësi që jo vetëm të ardhurat nga tarifat, por edhe gjërat e tjera, duke qenë se kemi një set të tërë elementesh të tjera të kontrollit, të jetë i përfaqësuar në bord.

Në rastin e IALPP-së, pyetja që duhet të bëhet, se të cilit janë të ardhurat e universitetit? Nuk janë të ardhurat e senatit, por janë të të gjithë universitetit, ku përfshihen brenda bordi, mirëmenaxhimi i bordit dhe i shtetit. Ato nuk janë të ardhurat ekskluzive që i ka senati. Institucioni është i tëri, ku përfshihet edhe bordi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Arbjan Mazniku – Institucioni është bordi, administratori dhe senati.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Arbjan Mazniku - Jo ato përfaqësojnë senatin dhe jo institucionin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Arbjan Mazniku – Në rastin e Universitetit të Tiranës, themeluesi ka dhënë 60 vjet histori, 60 vjet financime, kulturë, ndërtesa dhe të gjitha me radhë.

Në rastin e privatit, ai ka dhënë emrin, institucionin dhe krijimin e institucionit. Për më shumë, nëse do t'i kishim dhënë tarifat si të ardhura njërit prej grupeve, atëherë automatikisht nga tarifat, do të kishin lëvizur balancën. Ne duke e krijuar në këtë mënyrë

balancën, i kemi thënë institucionit, që si themelues ke vetëm gjashtë në momentin zero, nëse t'i nuk hedh para të tjera nga fondacioni, atëherë e humb gjashtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nëse shteti harxhon 100 lekë për universitetin që është 20% e buxhetit tërësor të universitetit, atëherë, shteti do të marrë 20% të bordit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk quhen tarifa të ardhura të fondacionit. Ky i fundit duhet të hedhë financim ekstra.

Nëse do ta bëjmë, atëherë duhet të detajomë diçka, por do të krijojmë më shumë siklet sesa do të sqaronim ndonjë gjë. Sqarimi është i qartë: në përputhje me financimin. Në rastin e universiteteve publike, siç e shpjegova pak më parë, nuk ka financim të tyre vetë, sepse nuk kanë të ardhura.

(Ndërprerje pa incizim.)

Secili përbëhet nga senati, nga bordi.

Mimoza Hafizi - Kemi një universitet që e ka buxhetin një milion, nga të cilat 500 mijë janë tarifatat e studentëve, 200 mijë vijnë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, ajo vlerë çdo vit përkthehet në diçka.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Me cilin do të barazohet gjashtëshja?

Në rastin e universitetit publik, ndarja përcaktohet mbi bazën e buxhetit, të atij trevjeçar, por për ta thjeshtuar po themi të buxhetit vjetor, pra të ardhurat që futen në universitet çdo vit. Unë po llogaris, një universitet IALPP-së ka buxhet një milion, nga të cilat 500 vijnë nga tarifatat e studentëve, 200 mijë janë qiratat që do të paguanin, por nuk i paguajnë, sepse themeluesi, fondacioni ka dhënë godinat ose mund të ketë dhënë një pasuri tjetër që përkthehet në vlerë vjetore dhe 300 mijë i jep shteti. Këto gjashtë vende do të ndahen 300 ndër 700? Pra, 500 plus 200 apo 300 ndër 200?

Plarent Ndreca - Ndajmë dy momente kontributesh: e para, është momenti zero, kur themeluesi është kontribuuesi kryesor, i vetëm. Ai ka themeluar institucionin dhe ka bërë të mundur fillimin e punës së institucionit. Ky është momenti që përcakton kontributet. Të ardhurat që krijon ky institucion, nuk mund të quhen më kontribute. Të gjitha llojet e të ardhurave janë për të gjithë institucionin, do t'i futen këtij institucioni dhe nuk mund të ndahen në mes të palëve. Nëse ka kontribut ekstra nga aktorë ekstra, atëherë ai i jep kundrejt kushtit për të marrë pjesë në Bordin e Administrimit. Çdo e ardhur e institucionit, është e këtij të

fundit. Rikthehen përsëri në institucion. Ka edhe fitime. Mund të ketë fitime në këtë rast, sepse mund të ketë veprimtari, për shembull nga patentat dhe i kthehen përsëri institucionit, por nuk mund të ketë lëvizje në bord, sepse është pasojë e kontributit të të gjithë institucionit dhe jo vetëm i senatit. Janë kontribut i senatit, i administratorit, i rektorit dhe i bordit. Te sh.p.k-të kur krijohet fitimi, shpërndahen në bazë të kontributit edhe fitimet, vetëm nëse futen lekë ekstra nga jashtë, atëherë mund të ndryshojnë kontributet.

Arbjan Mazniku- A mund të largohen dy nga ne, sepse duhet të shkojmë në Komisionin për Edukimin. Ata presin të mbarojë raporti këtu që të fillojnë.

Bashkim Fino – Kur ndryshon raporti i përfaqësimit mbi bazën e fondeve, gjithmonë gjashtëshja do të ulet, sepse i shtohen paratë, do të shtohen nga anëtarët e senatit apo nga ministria?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull.

Po i dha shteti, nga do t'i shtojë?

Plarent Ndreca - Nëse i jep Këshilli i Ministrave, do të kërkojë anëtarë në bord.

Bashkim Fino - Ti thua se anëtarët e bordit, të cilët ushtrojnë funksionet në institucionet e arsimit të lartë trajtohen sipas përcaktimeve në status. Pra, e lë të hapur. Anëtarët e tjerë janë të punësuar me kohë të plotë. Disa anëtarë të bordit, janë të punësuar me kohë të plotë, disa të tjerë me një lloj statusi që kanë aty ku punojnë. Pse kjo diferencë e anëtarëve të bordit? Ose duhet të jenë të gjithë anëtarët e bordit me kohë të plotë ose mund të mos jenë me kohë të plotë atje, por në punë të tjera dhe janë anëtarë të bordit, siç ndodh nëpër borde të tjera.

Plarent Ndreca - Qëllimi ka qenë, sepse mund të ketë profesorë në të njëjtin institucion që marrin pagën dhe janë të punësuar me kohë të plotë, por senati mund të vendosë t'i çojë si përfaqësues të tij në bord dhe nuk ishte e arsyeshme që ata të trajtohen si nëpunës me kohë të plotë në bord, ndërsa përfaqësuesi i ministrisë, për t'i dhënë një garanci dhe staturë tjetër anëtarit të bordit, e kemi konsideruar të jetë me kohë të plotë, të ushtrojnë atë funksion me përgjegjësi të plotë dhe të mos merren me çdolloj pune tjetër. Kjo ndarje ka këtë arsye.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Plarent Ndreca - Zoti Fino solli një rast shumë të mirë për ta sqaruar, sepse kjo ka qenë arsyeja që e kemi ndryshuar, pasi anëtarët e bordit, përgjithësisht kanë treguar se nuk kanë përgjegjësinë e duhur në ushtrimin e funksioneve në bord, kryesisht të shoqërive tregtare të shtetit. Ara shkonin dhe firmosnin në akte formalisht. Ne kemi tentuar që ky anëtar i bordit të bëhet me kohë të plotë, të paguhet për punën që bën dhe të përgjigjet për të.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk paguhen sipas mbledhjeve, por kanë një pagë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Diskutimi këtu është te koha e plotë, pra çfarë konsiderojmë me kohë të plotë. Këtë e vendos vetë institucioni, sesi e menaxhon kohën e plotë të funksionarëve të tij. Aktualisht ka dy lloj të anëtarëve të bordit, disa që paguhen me kohë të plotë, por në fakt janë honorifikë dhe disa që paguhen sipas mbledhjeve. Bordet e shoqërive tregtare dhe publike nuk paguhen sipas mbledhjeve, por kanë pagesë fikse. Nëse je anëtar i Këshillit të Mbikëqyrjes së një shoqërie tregtare, për shembull të INSUG-ut, paguhesh me pagë, 300 mijë lekë pagë në muaj, por sesa herë mbledhet bordi i INSIG-ut, kjo është çështje e brendshme e vetë INSIG-ut.

Bashkim Fino - Bordi është bord dhe si ky në rastrin konkret që po krijoni të ri, ashtu edhe bordet që janë në të gjitha institucionet e tjera të varura dhe ta pavarura, përsëri bord mbetet. Pra, do të thotë që mbledhet një herë në një muaj, dy muaj dhe të tjera me radhë. Trajtimin e anëtarëve të bordit do ta bëjmë siç e kemi bërë në të gjitha ligjet e tjera. Pse në këtë ligj, do ta bëjmë të veçantë? Në këtë projektligj themi: një, dy tre do të jeni me kohë të plotë, qëndro atje, mos bëj asnjë punë dhe me një mbledhje merr rrogën, ndërsa ti i ministrisë puno në ministri, shko atje si anëtar bordi, puno gjithë ditën...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, po ma dhatë shembullin. Unë kam qenë në Ministrinë e Arsimit, caktohem nga ministria anëtar i bordit të IALPP-së. Atje unë nuk do të bëj asgjë. Në ministri bëja diçka, isha specialist, shef sektori, apo ku di unë, drejtor, ndërsa atje, do të qëndroj tërë kohën dhe do të lexoj statutin e bordit dhe do të paguhem për një mbledhje që bëhet, por për të gjithë vitin. Kam këtë vërejtje: ta trajtojmë bordin, njëlloj si të gjithë bordet e tjera që kemi trajtuar në Komisionin e Ligjeve, sepse nuk mund të trajtohet kështu. Mua më duket e tepërt, një luks i madh për ata anëtarë, qoftë të senatit, qoftë të ministrisë dhe do të quhen anëtarë të bordit.

Plarent Ndreca – Ajo që dua të shtoj është fakti se paga nuk lidhet me kohën e plotë. Pagën mund t’ia japësh për shembull 400 mijë lekë, por duhet t’i shtosh përgjegjësinë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ideja është se ata që punojnë në një institucion, nuk mund të paguhen dy herë, sepse gjithsesi janë të institucionit. Është pedagog, është i institucionit, paguhet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pse e paragjykojmë se mund të jetë një mbledhje? Ata mund të bëjnë përditë mbledhje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj - Për nenin 120?

Bashkim Fino - Po, APP-ja ka një ligj, e thashë edhe unë edhe zoti Mediu, se ku janë rastet e përjashtimit nga prokurimi publik. Në rastin konkret ky është një ligj “Për arsimin e lartë” dhe nuk është një ligj për përjashtimin e rasteve të prokurimeve publike. Ndoshta Ministria e Arsimit duhet të na sillte këtu paralelisht me ligjin “Për arsimin e lartë” edhe amendamentin në ligjin “Për prokurimin publik”, ku të përjashtohet fondi i përfituar nga IALPP-ja, e cila ka të drejtë të bëjë tender pa prokurim publik dhe të hapur. Në rastin konkret, e futur kështu, bëjmë një katrahurë në ligje. Ne si anëtarë të Komisionit të Ligjeve duhet të jemi të kujdesshëm kur bëjmë ligje. Më kuptoni? Nuk kam asnjë vërejtje, nëse doni ta bëni kështu. E bëra pyetjen politike dhe thamë se është vendosur politikisht nga qeveria. Shumë mirë, por problemi është, a do të kemi një standard në këto ligje? I bie që nëse lexojmë ligjin “Për arsimin e lartë”, sepse atë kemi ligjin bazë, thuhet se: përjashtimet nga APP-ja janë një, dy, dhjetë raste”. Nuk e lexoj rastin e njëmbëdhjetë apo të dymbëdhjetë, janë edhe në një ligj tjetër bazë, janë në ligjin “Për arsimin”, mund të jenë në ligjin “Për pushtetin lokal”, i bie që duhet të shfletosh edhe ligje të tjera për të marrë vesh se çfarë ka përjashtuar APP-ja nga kjo situatë. A do të vëmë një rregull në legjislacionin tonë? Ky është thelbi i pyetjes. Nëse do të vëmë një rregull, do të thotë që ta fillojmë këtë rregull për nga hera, që kur të marrim një ligj dhe lexoj për përjashtimet e APP-së, atje t’i kem të gjitha. Kur marr një ligj dhe lexoj për përjashtimin nga Shërbimi Civil, atje të lexoj të gjitha se cili përjashtohet nga Shërbimi Civil dhe cili me Kodin e Punës, ndërkohë që ne kemi bërë një katrahurë në raport me shumë ligje të tjera. Para një jave sapo miratuam Agjencinë për Planifikimin e Territorit dhe e përjashtuam nga Shërbimi Civil, me apo pa të drejtë. Unë isha kundër, por kjo ka pak rëndësi, unë mbeta në minorancë, por problemi është se nuk e vumë te ligji “Për shërbimin civil”, se cilët janë rastet që përjashtohen, por e vumë te një ligj tjetër “Për planifikimin e territorit”. Planifikimi i territorit nuk ka lidhje me shërbimin civil, nuk ka lidhje APT-ja me ligjin “Për arsimin e lartë”. Ky është thelbi i diskutimit për këtë nen. Nuk jam kundër, nëse këta e duan dhe e kanë vënë politikisht, Ministria e Financave, Kryeministria kanë dhënë “ok”- ein, por kjo duhet të vijë në ligjin bazë të APT-së.

Fatmir Xhafaj – Keni ndonjë koment ndryshe?

Plarent Ndreca -Ka raste që janë bërë me ligje të posaçme, siç është për shembull ligji “Për kulturën”, ku janë përjashtuar nga funksionimi rregullat e prokurimit publik, sipas ligjit “Për prokurimin publik”.

Fatmir Xhafaj – Nuk keni argument tjetër?

Plarent Ndreca – Ky është një argument. Argumenti tjetër është fakti që të dy janë ligje me shumicë të thjeshtë.

Fatmir Xhafaj – Këtë do ta bëjmë me rezervë. Këtë qëndrim kemi mbajtur edhe për ligje të tjera. Sapo kemi kaluar tri ligje të tjera dhe kemi thënë që të ndryshoni te ligji “Për prokurimet publike”. Në rastin konkret keni të gjithë kohën e mjaftueshme, pasi këto nuk do të bëhen as këtë vit dhe as vitin tjetër. Qeveria do të jetë e detyruar sipas asaj që ka vendosur ligjvënësi edhe për turizmin dhe për këto të tjera, të mbajë të njëjtin qëndrim, të ndryshojë te ligji “Për prokurimin publik”.

Jemi dakord me këtë ndryshim.

Neni 121. “Inspektimi”.

Bashkim Fino - Ndoshta do të ishte më mirë të shkruhej ndryshe. Këtu thuhet: “...ministri përgjegjës për arsimin i propozon Këshillit të Ministrave vendosjen e kushteve për vijimin e veprimtarisë, nën mbikëqyrjen e ministrisë pezullimin e veprimtarisë deri në plotësimin e kushteve për një periudhë maksimale tre vjeçare, dyvjeçare” ose të tjera e të tjera. Kam përshtypjen se ky nen duhet të vendoset me kushte. Kushtet vihen me pika. Cili është propozimi që bën ministri i Arsimit në rastin konkret? Për shembull: “a” bën vërejtje, “b” bën këtë gjë, “c” bën një gjë tjetër dhe në fund fare është mbyllja e veprimtarisë së institucionit. Kështu do të ishte më e lexueshme dhe më e kuptueshme si nen sesa kështu e përgjithshme, sepse kështu do të thotë që ministri përkatës mund të vendosë deri në plotësimin e kushteve dhe të thotë: “stop”, por sa do të jetë ky stop deri në plotësimin e kushteve? Një muaj, dy muaj, tre muaj? Këtu nuk e thotë, ose duhet të thotë për një periudhë maksimale deri dyvjeçare.

Fatmir Xhafaj - Kështu thotë.

Bashkim Fino - Ose duhet të thotë mbylljen e veprimtarisë së institucionit. Deri sa të vijmë te masa ekstreme të mbyllja e veprimtarisë së institucionit, a nuk duhet që kushtet të jenë me pika konkrete me qëllim që të jetë më e lexueshme edhe për mua që e marr iniciativën të di se penalizohem nga ky nen, sipas tre-katër pikave kryesore? Do të ishte më mirë që këtu të bëhej një riformulim, më i saktë sesi do të veprojë ministri përkatës i linjës, por edhe unë që jam subjekt i interesuar, se nëse nuk e plotësoj, për shembull germat “a”, “b”, “c” dhe deri në fund që është mbyllja e veprimtarisë.

Fatmir Xhafaj - E keni gati riformulimin?

Vasilika Hysi - Është një çështje tjetër nga kjo që thotë zoti Fino, por unë do të doja të riformulonim dispozitën dhe të lexohej në këtë formë: “Kur nga inspektimet dhe mbikëqyrja

e ministrisë përgjegjëse verifikohet që IALPP-ja nuk përmbush kriteret ligjore për këtë formë institucioni, ministri përgjegjës për arsimin i propozon Këshillit të Ministrave vendosjen e kushteve, vijimin e veprimtarisë nën mbikëqyrjen e ministrisë, pezullimin e veprimtarisë deri në plotësimin e kushteve për një periudhë jo më gjatë se dy vjet”. Kushtet janë që duhet t’i plotësojë brenda dy vjetëve, pezullimi i veprimtarisë bëhet për dy vjet apo kushtet duhet të plotësohen për një periudhë maksimale deri në dy vjet?

Fatmir Xhafaj – Ky nen duhet të riformulohet i tëri. Titullin e keni vënë: “Inspektimi i veprimtarisë”, por në fakt nuk flitet për inspektim. Të krijoj idenë e masave. Ai që e lexon titullin mendon: cili e kryen inspektimin? Si bëhet ai? Ju e keni thënë praktikisht, por duhet ta përputhni titullin me një riformulim më elegant.

Plarent Ndreca - Dakord. Për kushtet që tha zoti Fino, bëhet fjalë për ato të parashikuara në nenin 117. Nëse një nga kriteret cenohet, atëherë...

Fatmir Xhafaj –Bëni një riformulim, bashkë me titullin.

Neni 122. “Dispozitat kalimtare”.

Vasilika Hysi - Zoti kryetar, dua të pyes juristin. Ne kemi nëpër universitete me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Kohën e plotë e kemi tre vjet, ndërsa kohën e pjesshme e kemi katër vjet. Kur themi “diplomat e studimeve universitare të lëshuara në Republikën e Shqipërisë që kanë zgjatur së paku katër vjet akademike”, bëhet fjalë për me kohë të plotë, sepse *part-time* është gjithmonë një vit më shumë.

Te pika 2, mendoj se duhet ta saktësojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nëpër fakultete, aktualisht që po flasim, ka me *part-time*. Ata nuk e bëjnë bachelorin tre vjet, por katër.

Mimoza Hafizi - Zonja Hysi ka shumë të drejtë, por duhet të precizohet: diplomat e programeve universitare. Kjo të mos lidhet me studimet personale, por me programin e studimit. Diploma e një programi studimi, pavarësisht sesa vjet e ka bërë ai person, rëndësi ka sesa është diploma realisht. Ky është mendimi im për të shmangur këtë konfuzion.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Plarent Ndreca – Te ligji aktual, këto të dyja janë përcaktimet, pra në të njëjtën formë. Lidhur me studimet me kohë të zgjatur, me *part-time*, programet janë tetë semestra, janë katër vite akademike, pavarësisht kohëzgjatjes kalendarike.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Programet universitare, nuk ka problem, e përshtatim këtë gjë, por si kohëzgjatje janë katër vjet dhe tetë semestra.

Fatmir Xhafaj – Dakord me ndryshimin, me riformulimin.

Neni 123. Nuk ka gjë. Jemi dakord.

Neni 124.

Po, zonja Hysi, por jo pyetje, sepse kemi bërë nga mëngjesi deri në darkë, kemi pesë ditë. Më thoni se çfarë kundërshtie keni.

Vasilika Hysi – Është e vërtetë që kodifikimi i programit duhet të bëhet pas një viti.

Fatmir Xhafaj – E keni fjalën për nenin 123?

Vasilika Hysi – Po. Te neni 123 themi se kodifikimi i programit do të fillojë në vitin 2016, po programet që janë tani, që nga momenti i miratimit të ligjit deri në vitin 2016 si do të bëhen?

Në fjalinë e dytë ju thoni: “ Procedura e programeve të reja dhe atyre ekzistuese do të bëhen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin”. Pra, ju thoni se kodifikimi i programit të studimit kryhet brenda një viti nga hyrja në fuqi e ligjit...

Fatmir Xhafaj - Ata e dinë se çfarë kanë thënë.

Vasiliak Hysi – Çfarë do të bëhet me këto programe?

Fatmir Xhafaj – Cila është përgjigjja?

Plarent Ndreca – *(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

...nënligjore për këtë çështje.

Fatmir Xhafaj - Neni 124. Jemi dakord.

Neni 125. Dakord.

Neni 126. Dakord.

Neni 127. Dakord.

Neni 128.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Thamë të vendosim, të ndajmë pjesën e publikut nga privati. Nuk ka kuptim t'i kthehemi.

Dakord me vërejtjet që janë bërë më sipër.

Neni 129. Dakord.

Neni 130. Dakord.

Neni 131. Dakord.

Neni 132. Kemi akte nënligjore që dalin në bazë dhe për zbatim të këtij ligji? Duhet t'i specifikoni.

Vasilika Hysi - Kam një pyetje. Ju thoni se këto që janë në proces doktrature do të vazhdojnë me ligjin ekzistues, po Këshilli i Profesorëve, a do të vazhdojë ndërkohë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj - Duhet të specifikoni nenet për të cilët nxirret akti, sepse është kusht, ta kërkon Kushtetuta, është detyrim kushtetues. Duhet të përcaktoni nenin bazë prej të cilit duhet të rrjedhin akte nënligjore, si edhe afatin.

Me nenin 132 jemi dakord.

Neni 133. Dakord.

Neni 134. Dakord.

Neni 135. Dakord.

Neni 136. Dakord.

Neni 137. Dakord.

Mos duhet që ta miratojë udhëzimin Këshilli i Ministrave? Miratohet nga Këshilli i Ministrave me propozim të ministrit të Financës dhe ministrit përgjegjës për arsimin për t'i dhënë më forcë? Dakord.

Neni 138.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E thamë më parë se duhet ta specifikojmë.

Jemi dakord me ndryshimet.

Neni 139. Dakord.

Neni 140. Dakord.

Neni 141. Dakord.

Qendrat shëndetësore universitare të njëjtën logjikë do të kenë?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi - Nëse ju kujtohet, te pika 5 ku thuhet se do të kenë të njëjtat kritere dhe më poshtë thuhet se kriteret specifike dhe procedurat e përzgjedhjes së drejtuesve të njësive bazë dhe të shërbimeve bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave, ka një kakofoni.

Zoti Plarent, ju do të na e sillnit të formuluar. Bëhet fjalë për nenin 27, pika 5.

Plarent Ndreca - Drejtuesi i shërbimit spitalor ose klinikës duhet të plotësojë të njëjtat kritere me ato të drejtuesit të njësive bazë në institucionet e arsimit të lartë. Pra, bëjmë një njehsim të drejtuesit të shërbimeve me drejtuesit e departamenteve në institucionin e arsimit

të lartë, ndërkohë që kriteret, procedurat për ngritjen dhe organizimin e shërbimeve të qendrave shëndetësore universitare, si edhe kriteret specifike për procedurat për përzgjedhjen i bën Këshilli i Ministrave me propozim të dy ministrave. Kjo do të thotë se një drejtues i shërbimit, përveç minimumit që duhet të ketë të ekuivalentuar me drejtuesin e departamentit, mund të ketë kritere shtesë që kanë të bëjnë me menaxhimin dhe me eksperiencën në shërbim.

Fatmir Xhafaj - Kjo nuk është e qartë, prandaj duhet ta riformuloni. Këtë gjë e kishim që herën e parë.

Po për nenin 44?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nëse ka qenë në debatet që kemi bërë, ne i kemi mbajtur shënim dhe i kemi riformuluar. Pra, është ezauruar.

Besoj se është e qartë. Ne kemi lënë mundësinë për të konkurruar edhe grada shkencore “doktor”, nëse nuk ka nga kategoritë e tjera më sipër.

Vasilika Hysi – Për të qartësuar se cilat janë funksionet që kryen drejtuesi i njësisë dhe cilat janë funksionet që kryhen drejtuesi i shërbimit, me qëllim që të jenë të qarta dhe të ndara këto gjëra, sepse kështu siç janë në ligj, nuk ka ndonjë ndasi midis funksionit të drejtuesit të njësisë bazë dhe drejtuesit të shërbimeve, ju keni thënë se këto përcaktohen në statut dhe në rregullore, pra i keni lënë çdo institucioni t’i përcaktojë vetë, ndërkohë që këto janë dy pozicione të ndryshme dhe fakti që përcaktoni krahas kritereve bazë dhe kriteret specifike, dëshmon më së miri që këto janë dy funksione të ndryshme: njëri që do t’i shërbejë pacientit dhe tjetri do të merret me kërkimin shkencor. Kjo duhet të jetë e qartë në ligj. Kjo është ideja.

Plarent Ndreca - Ne e kemi parashikuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Shumica dërmuese e kritereve vijnë nga Ministria e Shëndetësisë, sepse ata kanë në varësi shërbimet. Këto kritere përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe me propozim të dy ministrave. Kjo është arsyeja pse ia kemi lënë Këshillit të Ministrave përcaktimin e kritereve, të kompetencave dhe mënyrën sesi funksionojnë shërbimet. Nuk është objekt i këtij ligji rregullimi i shërbimeve spitalore.

Fatmir Xhafaj – Neni 44 dhe me 27 krijojnë problem, por do ta shikoni gjatë riformulimit.

Tani duhet të uleni: relatorja me këshilltaren, bashkë me një nga përfaqësuesit e ministrisë dhe të mbyllin raportin e Komisionit të Ligjeve për ndryshimet e miratuara. Pastaj do t’ia kalojmë komisionit tuaj për të vazhduar si komision përgjegjës.

Besoj se jeni të kënaqur nga bashkëpunimi. Jeni lodhur pak, por besoj se ia ka vlejtur për të bërë përmirësimet e nevojshme, duke qenë se është një ligj i rëndësishëm dhe i vështirë, por që në thelbin e tij nuk kishte ndryshime. Janë gjëra që mund të përmirësohen dhe kjo është e rëndësishme.

Faleminderit!

Mbyllim mbledhjen.

MBYLLET MBLEDHJA

